

Mbledhja e kryesisë së shoqatës 17shkurti.ch

PROTOKOLL

DATA: 20.08.2017

KOHA: 11:00

VENDI: GLATTBRUGG

THIRRUR NGA:	Kryetari Muhamet Guda
NUMRI I MBLEDHJËS	7
UDHËHEQËS I MBLEDHJËS	Muhamet Guda
PROTOKOLLIN E SHKRUAN	Visar Kryeziu
PJESËMARRËS	Muhamet Guda, Agron Zahiri, Visar Kryeziu, Faik Mahmuti
MUNGOJNË	Avni Kastrati

TEMAT E DITËS

1. Prezentim te projekteve nga Qendresa Sadriu
2. Vleresimi i javes kulturore
3. Pagesa e punetoreve te mirembajtjes
4. Vleresimi i aksioneve: a) Operimi i nje pacienti b) Blerja e shtepise
c) Ndertimi i parkut te ri
5. Projekti i uleseve pergjate rruges kryesore
6. Te ndryshme

DISKUTIMI	1. Prezentim te projekteve nga Qendresa Sadriu		
Qendresa Sadriu eshte kshilltare ne kuvendin komunal te Opfikon-Glattbrugg-ut. Ajo para kryesise kishte per ti paraqitur dy projekte te cilat do te realizohen ne bashkpunim me shoqaten 17shkurti.ch. Ndersa nje projekt tjetër do ta paraqet ne te ardhmen, projekt i cili eshte me rendesi me te veqant. Qendresa spjegoi qe ne Glattbrugg jetojne rreth 3000-4000 shqiptare. Duke u nisur nga kjo tha se ne mund te perfitojme sikurse qe jane italianet qe per cdo muaj permes gazetes te qytetit te Glattbruggut, nje here ne muaj te gjithë italianet informohen ne gjuhen italiane ne nje faqe te tere. Njejte mendon qe mund te kemi edhe ne te njetjen mundesi. Por ajo ka nevoj per mbeshtetjen e shoqates tone ne menyre qe Qendresa ta paraqes kete propozim ne kuvendin e komunes. Cdo muaj nje faqe ne gjuhen shqipe duhet te shkruaj dikush nga ne, ne menyre vullnetare dhe kjo faqe ne gjuhen shqipe do te jete pjese e gazetes zvicerane qe shperndahet ne tere qytetin. Propozimi i pelqej kryesise dhe mundesite qe te behen shkrime per kete gazete ne gjuhen shqipe ishin: Visar Kryeziu , Enver Foniqi, Imran Asllani apo dikush tjetër nga qyteti qe mund te shkruaj. Propozim per te biseduar per kete qeshtje edhe me shoqaten tjetër shqiptare te Glattbruggut „Glattalb“ dha Agron Zahiri, i cili tha se do te ishte mire te jemi se bashku ose te kemi pelqimin edhe te asaj shoqate. Muhameti pyet nese guxon te mbetet kjo faqe ndonje muaj pa shkrim, mirepo Qendresa tha se nese fillohet atëher nuk guxon qe njehere te mbetet zbrazet e njehere te shkruhet. Visari ishte i mendimit se kete projekt nuk deshiron ta shih si entuziasem i madh ne fillim dhe pastaj te mos kete me interesim askush per te shkruar dhe pyet nese eshte e mundur te gjendet menyra e pageses se „gazetarit“ i cili e ben shkrimin, per cdo shkrim diku rreth 50-100 SFR. Mundesite per pagese te shkrimeve u pane te veshtira per momentin. Ky propozim mori pelqimin e kryesise. Projekti tjetër i Qendreses ishte qe per 50 vjetorin e komunes se Glattbruggut (2018) ne mesin e 300 projekteve jane perzgjedhur nga komuna 50 projekte dhe ne mesin e tyre ishte edhe projekti i Qendreses dhe Visar Kryeziut. Behet fjale per ekspozite te fotografise qe do ti bëj Visari te personave qe jane 50 vjeq, apo qe jetojne qe 50 vite ne kete qytet apo diqka qe krijojne numrin 50. Projektin e udheheq Qendresa, Visari i ben fotografite kurse shoqata jone te jete mbeshtetese e projektit. Qendresa tha nga shoqata kerkon mbeshtetje si psh gjetjen e personave qe e „bejne“ 50-shin, shperndarjen e ftesave apo njoftimeve te ekspozites etj. Edhe ky projekt u mireprit nga kryesia dhe mori pelqimin e saj. Keto dy projekte u perkrahen nga kryesia ne menyre unanime.			
VENDIMI			
U perkrahen keto dy projekte nga kryesia.			
DETYRAT	PERSONI PËRGJEGJËS	TERMINI	
Qendresa na njofton per hapat e metutjeshme	Qendresa Sadriu	/	

DISKUTIMI	2. Vleresimi i javes kulturore	
Muhameti thote se Avnia eshte keq qe mungon sot ketu sepse kemi pasur me bisedu per javen kulturore. Agroni thote se Avnia do te duhej sot te jepte raport per javen kulturore per hyrje daljet dmth per raportin financiar si dhe te sjelle te gjitha fakturat. Agroni vlereso i organizimin si te suksesshem dhe i mire. Shpreson qe edhe ne vitin e ardhshem keta ta marin pergjegjesine per organizim. Visari thote se organizimi ne pergjithesi ishte i mire, mirepo ka vend per permiresime si psh edhe pse nuk ishte i detyruar ne kete organizim nese ky vete nuk do ti organizonte per te bere fotografi si dhe te del dhe te bej video-ingjizime sigurisht se do te mbeteshim pa keto. Gjithashtu tha se ua ka rikujtuar qe te falenderohen sponzoret dhe sponzori gjeneral i shoqates. Agroni thote se Avnia u desht te angazhohet me shume ne kete turnir, pasi e ka mar pergjegjesine per kete projekt, ne veqanti eshte dasht me bo vendosjen e marketingut te sponzorit gjeneral ne vendin e duhur. Faiki thote se nese ka pas gabime ateher keto gabime jane te gjitha te tonat sepse Avnia ka qene i percaktum vetem per me i perzgjedh organizatoret e turnirit. Agroni nuk pajtohet me Faikin qe Avnia eshte zgjedhur vetem per mi perzgjedhur organizatoret e turnirit. Muhameti thote se organizimi ne pergjithesi ka qene i mire. Imrani gjithashtu tha se organizimi ka qene i mire ne pergjithesi. Agroni thot te shkruhet nje falenderim per organizatoret e turnirit, te falenderohen sponzori gjeneral si dhe Qamil Sadriu. U permend per problemet e organizimit te javes kulturore, shkaku i manifestimit te deshmoreve, pasi ka pasur keqkuptime. Agroni tregon qe pasi ka degjuar për keto probleme, i ka ftu te gjitha partite politike si dhe familjet e deshmoreve ne Dobercan per me bisedu per kete teme. Agroni tha se i ka thene pjesemarresve qe shoqata deshiron nje zgjidhje qe pajtohen te gjitha. Pas diskutimeve te mira, te gjitha u pajtuan qe cdo 5 vjet (vitet Jubilare) te kete manifestim madheshtore. Ndersa cdo vit te kete nga nje manifestim te shkurter. Por patjeter duhet te mbajme fjalime rreth deshmoreve te fshatit para se te luhet finalja e turnirit te futbollit, pasi qe gjitha ky aktivitet behet ne emer te deshmoreve te fshatit. Agroni tha se gjitha u ndane te kenaqur nga ky takim. Ne emer te shoqates tone Agroni i ka falenderuar te pranishmit ne kete takim. Manifestimi kujtimor jubilar do te mbahet ne viin 2019. Te shkruhet nje falenderim per organizatoret e turnirit, te falenderohen sponzori gjeneral si dhe Qamil Sadriu.		
VENDIMI	Te shkruhet nje falenderim per organizatoret e turnirit, te falenderohen sponzori gjeneral si dhe Qamil Sadriu.	
DETYRAT	PERSONI PËRGJEGJËS	TERMINI
Avnia te jap raport financiar mbi javen kulturore. Visari te shkruaj shkrimin falenderues.	Avni Kastrati dhe Visar Kryeziu	/

DISKUTIMI	3. Pagesa e punetoreve te mirembajtjes		
Faiki propozon qe puntoret mirembajtjes te kene konto si dhe pagesat e rrogave nga shoqata te behet direkt ne konto te puntorit . Faiki thote se nese vazhdohet me zhagitjen e pageses per punetor ateher sigurisht se do ti humbemi edhe punetort ma te mire qe i kemi. U votua unanim nga kryesia qe pagesa per punetoret te behen permes kontos. Arkatar i shoqates Agron Zahiri permes postes (Efinance) ua dergon rrogat punetoreve mirembajtes ne konto te Agron Murselit (mbikqyres i punetoreve) ndersa Agron M. ia ndan rrogen edhe dy punetoreve tjere. Gjithashtu per te ecur punet me lehte dhe mbare u vendos nga kryesia qe per prishje apo pjese te nevojshme per mirembajtje Agron M. te jete vete pergjegjes dhe vetem e njofotn arkatarin kurse arkatari kryesine per shpenzimet qe jane bere. Kryesia eshte shume e kenaqur me punen qe po bene Agron M. dhe ka shume besim ne te.			
VENDIMI			
Agron Murseli eshte vete pergjegjes per punetoret tjere, mjetet, prishjet dhe mirembajtjen e fshatit.			
DETYRAT	PERSONI PËRGJEGJËS	TERMINI	
Agron M. per shpenzimet e nevojshme e informon arkatarin e shoqates.	Agron Murseli	Menjeher	

DISKUTIMI	4. Vleresimi i aksioneve: a) Operimi i nje pacienti b) Blerja e shtepise c) Ndertimi i parkut te ri		
Imran Asllani njofotoi edhe njehere rastin per Sabedinin se si ishte gjendja, sepse per kete pike kryesia ne menyre urgjende kishte biseduar vetem permes telefonit dhe ishte marr vendim aty per aty per te filluar aksioni. Sipas Imranit rasti ishte me te vertet serioz dhe se kemi bere mire me aksionin. Pacienti ishte operuar dhe kishte pasur jo vetem nje here sulm ne zemer, por per fat te mire e kishte kaluar me sukses. Familja ishte detyruar qe te merr para hua per operim dhe deri me tash kane ndihmuar mjaft njerez por qe ka nevoj ende per ndihme financiare pasi qe ende nuk jane tubuar te gjitha te hollat. Imrani tregon per parkun ku thote se ka edhe sot pune qe te kryhen punet perfundimisht. 1400 euro ka kushtu komplet parku (pa shporta dhe banka). Visari thote qe e shih pune te mire ndertimin e parkut por ka vrejteje per kryesine se ky projekt ka filluar hiq pa votuar kryesia si dhe e kundershton kete menyre te punes se shoqates dhe thote qe nuk guxon te perseritet me i njeti gabim. Mahalla e eperme ka fillu aksionin per tubimin e te hollave per rregullimin e parkut dhe ne bashkpunim me shoqaten qe ka bere nje aksion. Ky debat i mos-pyetjes fare te kryesise hapi debatin edhe te makines se pastrimit te rrugeve ku ishte blere pa pyetur fare dy anetare te tjere te kryesise. Faiki kundershton menyren e blerjes se maqines per pastrimin e rrugeve pa pyetur fare Faikin dhe Visarin. Edhe Visari ishte i njetit mendim sikurse Faiki dhe dhane vrejteje per pjesen tjeter te kryesise. Agroni dhe Muhamedi than qe Avnia i ka pyet per makinen permes telefonit, por nuk kane pasur informata qe aneteret kryesise Visari dhe Faiki nuk jane pyetur fare. Agroni thot se ky gabim nuk guxon te ndodhe herave tjera. Agroni tregon qe u takua me Dr. Behlulin dhe ai ka kerkuar bashkpunimin me shoqaten ne menyre qe te perfundoj ky aksion sa me shpejt. Muhamedi tregon se ishte kategorikisht kunder idese qe te dalin te tubojne te holla shtepi per shtepi ne fshat ne emer te shoqates. Faiki thote se per shtepien duhet te thrrasim ne telefon anetaret e shoqates njejte sikurse per shtepite tjera. Visari poashtu menodn njejte per telefonatat Per shtepien te shkruhet nje shkrim me listen e personave qe kane kontribuar te cilen per momentin e posedon Imrani.			
VENDIMI			
Te shkruhet nje shkrim me listen e personave qe kane kontribuar per blerjen e shtepise. Sapo te perfundon aksioni i makines, te mirremi aktiv me projektin e shtepise (edhe me telefonata).			
DETYRAT	PERSONI PËRGJEGJËS	TERMINI	
Visari te shkruaj shkrimin	Visar kryeziu	/	

DISKUTIMI	5. Projekti i uleseve pergjate rruges kryesore		
Visari spjegoi per bankat ku kishte marr nje ofert sa ishte ne Kosove dhe po mbetet puna qe me i mar edhe dy oferta tjera ne menyre qe te plotsohen kriteret e shoqates. Visari interesohet edhe per dy oferta tjera. Muhameti thote qe buxheti i shoqates po rrezikohet, dhe ky projekt nuk eshte patjeter me i perfundu.			
VENDIMI			
Te merren edhe dy oferta tjera per uleset.			
DETYRAT	PERSONI PËRGJEGJËS	TERMINI	
Visari te mer edhe dy oferta tjera per uleset.	Visar Kryeziu	/	

DISKUTIMI	6. Te ndryshme	
Visari njoftoi qe Armen Sopi ia ka dhene 50 € per te paguar anetaresine per vitin 2017, kurse Armendi per vitin 2016 kishte paguar anetaresine mirepo nuk figurionte ne liste emri i tij. Per kete problem e njofoti Agronin si arkatar dhe Agroni mbetet qe te kontaktoj Armendin. Agroni thote se makina e pastrimit ende nuk jane tubuar te gjitha mjetet e nevojshme, dhe duhet patjeter te bej me telefonata per te tubuar te holla. U vendos nga kryesia qe te vehen telefonata per tubimin e te hollave. Visari tregon qe ne emer te shoqates pune kryesit e kamp-shtepizes (te urime pavaresia) ka pare qe nuk kane lare borgjin (huane) ne nje shitore ne Doberçan. Agron Zahiri propozon qe askush nuk guxon te merr hua (borgj) ne ndonje shitore ne emer te shoqates. Dhe asnje shitore mos te jep hua ne emer te shoqates. Ky propozim mori miratimin e kryesise. Agroni njofton se 600 euro i ka mar prej Abdyl Megjinit, te cilat do ti ruaj ne konto te shoqates dhe ben apel qe te paguajne edhe te tjeret. Agroni falenderon bacin Abdylmegjit dhe Arlindin per angazhimin e tyre. Agroni ne menyre qe te shtohet interesimi i antaresimit, propozon qe te kete nje loje shperblyese per antaret lokal qe paguajne anetaresine deri ne fund te muajit Tetor, ku nga 10 euro i japin Agroni dhe Faiki, dmth perfitues te ketyre te hollave te jene dy antare lokal nga 10 Euro, dhe loja do te jete e hapur deri ne fund tetorit. Terheqja e fituesve do te transmetohet live ne faqen zyrtare te shoqates ne facebook. Agroni thote qe gjendja financiare e shoqates nuk eshte ne gjendje te mire shkaku i daljeve te shumta nga konto shoqates. Agroni thote qe mos te kete dalje te tjera shkaku qe buxheti eshte mjaft i vogel. Gjithashtu njofotoi se mbajtset e flamurave Gania ka mbet me i shtu edhe disa dhe ato qe jane me i shtrengu.		
VENDIMI		
Telefonata per makinen e pastrimit te rrugeve. Hua ne emer te shoqates nuk guxon askush te merr dhe te jep. Te vendosen mbajttese te flamurave dhe te riparohen/shtrengohen te tjerat ne fshat nga Gania.		
DETYRAT	PERSONI PËRGJEGJËS	TERMINI
Gania te vendos mbajttese te flamurave dhe te riparon/shtrengon te tjerat Agroni te kontaktoj direkt me Armend Sopin	Gania	/